



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

**Gjinazi: drejtimi shoqëror dhe i përgjithshëm
(kurrikula e vjetër)**

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Ernest Koliqi****Tregtarë flamujsh**

Pyetja 1	B	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë

Pyetja 8 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Flamuri është simboli identitetit kombëtar, i fitoreve dhe lavdisë. Flamuri është shenja dalluese e një kombi.
- Titulli i tregimit nënkupton që ky simbol i shenjtë është kthyer në një mall, që shitet e blihet.

1 pikë Nëse tregon se çfarë përfaqëson flamuri si simbol kombëtar.

1 pikë Nëse tregon simbolikën që fiton në titull.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 9 (a) **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Për të dy personazhet koncepti që ndajnë për atdheun është krejt i ndryshëm.
- Për tregtarin, atdheu është çdo vend ku mund të pasurohesh dhe të jetosh pa nevojën e tjetrit.
- Tregtari nuk do t'ia dijë nëse ka apo nuk ka Shqipëri, por kush i blen flamujt e tij.

Ilustrim: *u shitën, a s'u shitën flamujt, qëndroi apo jo Shqipëria, unë kam mjaft me jetue.*

- Për poetin, atdheu është i shenjtë, është krenari, identitet dhe këtë shënjtëri, ai e gjen më së miri në simbolin e kombit, flamurin.

Ilustrim: *po te kishte parë dy duer të ndyta.....ose ëndërrimet e poetit – “mija agimesh epopeje të kuqe, fjetë në burgun e nje kohe të mugët”.*

OSE

- Hilush Vilza është poet, fantazon për të bukurën, idealist. Ai mendon se ushqimi shpirtëror është i domosdoshëm për të gjithë. Për të flamuri s'është shenjë kombëtare.
- Gaspër Tragaçi është tregtar, materialist. Ai mendon se poezia nuk është e dobishme, nuk ka vlerën që ka malli i tij i shitur.

2 pikë Nëse shpjegon ndryshimin midis dy personazheve (nga një pikë për secilin)

DHE

1 pikë Nëse gjen një moment në fragment ku shfaqet ky ndryshim.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 9 (b) 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Jo nuk mund të pajtohen.
- Të dy qëndrimet nuk mund të pajtohen pasi përfaqësojnë dy mentalitete të ndryshme, dy botëkuptime të ndryshme, të kundërta, që lidhen me probleme të çështjes kombëtare.

1 pikë Nëse tregon se të dy qëndrimet nuk mund të pajtohen.

1 pikë Nëse shpjegon arsyen e këtij mospajtimi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 2 pikë**Model përgjigjeje****Tipare të prozës poetike:**

- ka figura dhe imazhe të gjalla si në një pikturë;
- ka jehona e kumbime;
- muzikalitet të frazës;
- shije;
- ngjyra;
- nota të një lirizmi të theksuar;
- ritëm poetik;
- pasuri elementesh figurative (epitete).

2 pikë Nëse zbulon dy veçori që e bëjnë të jetë një prozë poetike.

OSE

1 pikë Nëse zbulon vetëm një veçori që e bën të jetë një prozë poetike.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 2 pikë

1 pikë Nëse gjen një **emër** në trajtën dialektore dhe e kthen atë në normën letrare.

DHE

1 pikë Nëse gjen një **folje** në trajtën dialektore dhe e kthen atë në normën letrare.

OSE

1 pikë Nëse gjen një folje dhe një emër në trajtën dialektore, por nuk e shkruan ose i shkruan gabim në normën letrare.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12 1 pikë

1 pikë Koliqi kërkon të dëshmojë se në atë kohë atdhetarizmi ishte më shumë një deklaratë, se sa një pasion, një identitet kombëtar.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Faktet që i bashkojnë janë:

- studimi jashtë Shqipërisë;
- mendësia përparimtare
- aftësia e të shkruarit. H.Vilza është poet.

2 pikë Nëse zbulon dy tipare të ngjashme mes H. Vilzës dhe Koliqit.

OSE

1 pikë Nëse zbulon një tipar të ngjashëm mes H. Vilzës dhe Koliqit.

PJESA II**Zhan Rasin****Andromaka**

Pyetja 14 **B** **1 pikë**

Pyetja 15 **A** **1 pikë**

Pyetja 16 **D** **1 pikë**

Pyetja 17 **C** **1 pikë**

Pyetja 18 **A** **1 pikë**

Pyetja 19 **D** **1 pikë**

Pyetja 20 (a) **2 pikë****Model përgjigjeje**

- Gjendjen e rënduar shpirtërore të Andromakës e ka shkaktuar pozicioni në të cilën ajo ndodhet. Nëse nuk martohet më Pirron ajo rrezikon të humbasë djalin. Nga ana tjetër nëse e pranon kërkesën e Pirros, ajo duhet të shkelë mbi kujtimin të shoqit dhe atyre mijëra njerëzve që u dogjën dhe vranë edhe për shkak të Pirros. Pra, ajo ndodhet në një gjendje pa rrugëdalje.

1 pikë Nëse tregon se çfarë e ka shkaktuar gjendjen e vështirë shpirtërore në të cilën ndodhet Andromaka.

1 pikë Nëse mendimin e ilustron edhe me detaje ose vargje nga fragmenti.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 (b) **1 pikë****Model përgjigjeje**

- Pirroja është gjakësor, vrasës dhe ajo s' mund të martohet me të.
- Është e lidhur shumë me kujtimin e të shoqit.
- Nuk mund të harrojë vëllezërit dhe të vvarët e tjerë.
- **Etj**

1 pikë Nëse identifikon një arsye.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 (a) 1 pikë

1 pikë Atmosfera e luftës së Trojës tregon se sa të lidhura janë me të fatet e heronjve. Ajo krijon një mjedis alarmi, frike të vazhdueshme. Nga ana tjetër i shërben Andromakës për të rigjetur forcat dhe mos pranuar kërkesën e Pirros. Gjaku që u derdh në të, të vdekurit nuk mund të harrohen. Duke e risjellë, ajo lë të kuptojë se një martesë e tillë është e pamundur.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një interpretim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.

Pyetja 21 (b) 3 pikë**Model përgjigjeje****Fjalët kyç:**

- *të atin që ra përpara meje;*
- *Pirron, synxirë n'ata parmakë;*
- *zjarr e flakë;*
- *M'i shkelte ata vëllezër;*
- *Në gjak i tërë përlyer vriste;*
- *natë ferri.*

Tabloja e krijuar

- kasaphanë, zjarr, shkatërrim dhe vdekje. Përfytyrimi është i kobshëm dhe mes tij qëndron Pirro që vret njeriun e saj më të shtrenjtë.

2 pikë Nëse zbulon disa nga fjalët kyç (më shumë se 1).

DHE

1 pikë Nëse tregon tablonë që krijojnë ato.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë**Model përgjigjeje**

- Për Andromakën Pirroja është: *gjakësor, vrasës.*
- Për Sefizën Pirroja është: *mbret i madhërishtëm, modest, trim.*

1 pikë Nëse tregon se si vjen përmes Andromakës portreti i Pirros

1 pikë Nëse tregon se si vjen përmes Sefizës portreti i Pirros

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 (a) 2 pikë

1 pikë **Koha e tashme:** *Të shkojmë atje te varri, të pyesim burrin tim, Shko ti më mir' i thuaj*

1 pikë **Koha e shkuar:** *M'i shkelte ata vëllezër të hapte një rruginë, Për turp ma hiqnin zvarrë rreth mureve, etj.*

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 (b) 1 pikë

1 pikë Mbizotëron koha e shkuar, sepse Andromaka i referohet shumë së shkuarës, kujtimit të të shoqit dhe Trojës së djegur. Është ajo kohë që përcakton edhe vendimin e saj. Është pesha e së shkuarës që dikton çdo sjellje, veprim dhe fatin e saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 3 pikë**Model përgjigjeje**

➤ Andromaka është në një gjendje shumë të rënduar shpirtërore. Ajo shfaqet në kulmin e dëshpërimit dhe ankthit. Pasthirrmat *Bobo! o bir*, apostrofat: *O eshtrat e tim shoqi! O Trojë, o ti o atë!* Zbulojnë pikërisht këtë gjendje të rënduar. Ndërsa inversioni dhe epiteti: *Sa shtrenjtë' po të paguan o bir, kjo nën e ngratë!* ku theksohet *sa shtrenjtë* dhe *e ngratë*, tregojnë se ajo tashmë e ka kuptuar se këmbëngulja e saj mund t'i kushtojë jetën djalit.

1 pikë Interpretimi.

2 pikë Nëse zbulon dhe dy figura bashkë me ilustrimet përkatëse.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton se çfarë e bën kaq të fuqishme figurën e Andromakës.
- shpjegon pse mendon se është i tillë.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga fragmenti ose vepra.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË **2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 - hyrjen
 - zhvillimin
 - përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI **2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE **2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.